

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët–Valdete Daka, kryetare, Nesrin Lushta e Avdi Dinaj-anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit T. T. nga Ferizaji, për shkak të veprave penale vrasje nga neni 178.të KPK dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375.par.2.të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR.nr.91/2014 të datës 04.03.2016. dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.269/2016 të datës 13.06.2016., në seancën e mbajtur më 01.11.2016., mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit T. T. anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR.nr.91/2014 i datës 04.03.2016. dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.269/2016 i datës 13.06.2016. në pjesën që ka të bëjë me veprën penale vrasje nga neni 178.të KPK dhe lënda në këtë pjesë i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Në pjesën që ka të bëjë me veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375.par.2.të KPK, aktgjykimet ngelen të paprekura ndërsa dënimi i shqiptuar për këtë vepër penale merret si i vërtetuar.

Ndaj të dënuarit vazhdohet paraburgimi.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR.nr.91/2014 të datës 04.03.2016. i dënuari T. T. është shpallur fajtor për veprat penale vrasje nga neni 178.të KPK dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375.par.2.të KPK dhe pasi për veprën e parë penale është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) vitesh ndërsa për veprën e dytë penale dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, është gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) vitesh e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 16.01.2014. e tutje. I është shqiptuar edhe dënimi plotësues i konfiskimit të një kornize të revoles “Ekol Special” e kalibrit 9 mm me gas, nr. Serik EV980765, një revole e tipit “Ekol Special” e kalibrit 9 mm me numër serik EV1292293, dy karikator të zbrazur me kapacitet prej 10 fishekëve të kalibrit 7,65x17 mm të dizajnuar për këtë revole dhe një fishek i therur në kapsollën ndezëse i kalibrit 7,65x17 mm. Është obliguar të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor.

Në procedurën ankimore, me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.269/2016 të datës 13.06.2016. është aprovuar ankesa e Prokurorit Themelor në Ferizaj dhe ankesa e të dëmtuarit I. M. ashtu që aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar përkritazi me vendimin për dënimin dhe pasi që për veprën e parë penale është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh ndërsa dënimi për veprën e dytë penale është marrë si i vërtetuar, është gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtën e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati B. T. nga Prishtina, nga referati i së cilës del se aktgjykimet kundërshtohen vetëm në pjesën që ka të bëjë me veprën penale vrasje nga neni 178.të KPK, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që të anulohen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit me parashtrësën KMLP.II.nr.192/16 të datës 14.10.2016. ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesa është e bazuar.

Sipas pretendimeve në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është kundërthënës me arsyet e paraqitura dhe me shkresat e lëndës, të cilat posaçërisht manifestohen në faktin se gjykata i ka ndarë dëshmitarët në dy grupe-në ata që kanë qenë në shoqëri me të dënuarin dhe ata që kanë qenë në shoqëri me tani të ndjerin A. M., duke thënë se secili prej tyre ka dhënë dëshmi në favor të të dënuarit apo të tani të ndjerit, varësisht se cilit grup i takon, por me këtë rast arsyet janë të mangëta sepse dëshmitari L. J. edhe pse ka qenë në shoqëri me tani të ndjerin, ka thënë se i tërë grupi (edhe ai vet) kanë qenë ta pajisur me mjete për sulm dhe se i ndjeri A. ka pas një sëpatë, ashtu që deklarata e tij është përputhur me deklaratën e të dënuarit. Mirëpo, gjykata nuk ka kushtuar rëndësi kësaj deklaratë por e ka anashkaluar. Në kërkesë thuhet se është bërë shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale sepse në aktgjykimin e shkallës së parë, kur është arsyetuar dashja e të dënuarit për të privuar nga jeta të ndjerin A., është thënë se ai “nuk tregon dashje të paramenduar, e cila shprehet në rastet kur vendimi për të kryer veprën penale merret para se të kryhet vepra penale.....dashja për të privuar nga jeta të ndjerin është formuar në çast, gjatë zhvillimit të ngjarjes”. Këto të meta nuk janë mënjeluar me aktgjykimin e shkallës së dytë edhe pse kanë qenë të potencuara në ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë ashtu që edhe aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje të njëjta esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Gjykata Supreme gjeti se këto pretendime janë të bazuara për këto arsye:

Nga aktgjykimi i shkallës së parë del se nuk kanë qenë kontestuese faktet se para ditës kritike dhe mu në atë ditë, por ngjarjes inkriminuese, kanë ndodhur konflikte dhe përlëshje fizike në mes të dënuarit T. T. dhe dëshmitarit B. K.

Në ditën kritike në vendin ne ngjarjes janë takuar dy grupe të personave. Në njërin grup ka qenë i dënuari T. T. me dëshmitarët L. S., R. I. dhe Sh. L. ndërsa në grupin tjetër, tani i ndjeri A. M. dhe dëshmitarët B. K., L. J., E. M. dhe F. Sh.. Grupi i parë ka qenë duke hecur ndërsa grupi i dytë deri afër vendit të ngjarjes ka ardhur me automjet, nga i cili kanë zbritur i pari dëshmitari B. K. e pas tij tani i ndjeri A. M. dhe të tjetër.

Se grupi i tani të ndjerit ka dal me automjet për të takuar dhe “për të biseduar me T. lidhur me një problem në mes tyre”, ka deklaruar dëshmitari E. M., ndërsa dëshmitari L. J. ka thënë se B. K. dhe E. M. kanë thënë që të dalin në qytet “për ti kërkuar T. dhe shokët e tij me qëllim që ti rrahin për shkakun se T. gjatë asaj dite e kishte rrahur B.”.

Sipas mbrojtjes së të dënuarit, kur kanë dal nga automjeti, tani i ndjeri A. ka pas sëpatë ndërsa B. dhe E. nga një dru; dëshmitari Sh. L. ka thënë se i gjithë grupi ka pas mjete siç janë drunjë apo hekura; dëshmitari R. I. se disa prej tyre kanë pas drunjë dhe dëshmitari L. J. ka deklaruar se i tërë grupi i A. ka pas mjete për sulm-A. sëpatë, B. armaturë, E. dhe ai (vet dëshmitari L.) nga një dru.

Deklaratat në fjalë janë përshkruar edhe në aktgjykimin e shkallës së parë.

Megjithatë, në arsyet e aktgjyimit të shkallës së parë (faqja 13 pasusi i dytë) është thënë se fakti se i ndjeri A. ka patur në dorë një dru apo sëpatë, nuk është vërtetuar nga shumica e dëshmitarëve, varësisht nga fakti së “në cilin grup anë kanë qenë” . Gjykata Supreme konstatoj se kjo bie ndesh me faktin se dëshmitari L. J. edhe pse ka qenë në “grupin e tani të ndjerit” ka deklaruar se tani i ndjeri A. në dorë ka pas sëpatë. Për më tepër, edhe dëshmitari B. K., po ashtu nga ky grup, ka deklaruar se tani i ndjeri A. në dorë ka pas një “bisht sëpatë”, që i bënë arsyet e këtilla të pakuptueshme dhe kundërthënëse, siç me vend theksohet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Për shkak të arsyeve të këtylla të cilat janë të paqarta dhe në kundërshtim me përmbajtjen e deklaratës së dëshmitarit L. J., në aktgjykimin e shkallës së parë kanë ngelur dubioza lidhur me zhvillimin e mëtutjeshëm të ngjarjes kritike, pasi pjesëmarrësit mu për faktet vendimtare-se çfarë veprimesh janë ndërmarrë nga i dënuari, tani i ndjeri apo ndonjëri prej personave tjerë të pranishëm, kanë dhënë deklaratë kundërtënëse.

Në faqen 13 pasusi 2 të aktgjykimit të shkallës së parë është thënë se të gjithë dëshmitarët kanë deklaruar se asnjëri prej këtyre personave (as tani i ndjeri A.) nuk e ka qëlluar të dënuarin T. Një konstatim i këtillë është në kundërshtim me përmbajtjen e deklaratave e shumicës së dëshmitarëve të dëgjuar, sepse dëshmitarët Sh. L., R. I. e L. S. kanë deklaruar se këtë pjesë të ngjarjes kritike nuk e kanë pa. Në anën tjetër, sipas deklaratës së të dënuarit, i cili po ashtu ka thënë se nuk ka marrë ndonjë goditje nga tani i ndjeri A., del se pasi nga automjeti kanë dalë dëshmitari B. dhe tani i ndjeri A. dhe kanë shkuar në drejtim të dënuarit, i dënuari ka nxjerrë revolen dhe ka shtënë (në ajër) dhe askush nuk është qëlluar, revolva është demoluar e pastaj, dëshmitari B. është shtrirë në tokë por tani i ndjeri A., sipas deklaratës së të dënuarit, ka ngelur afër tij dhe dorën në të cilën e ka pas sëpatën, e ka pas të ngritur dhe në këtë moment i dëmtuari e ka qëlluar me thikë.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se i dënuari nuk ka vepruar në mbrojtje të nevojshme e as në tejkalimin e kufijve të saj, për arsye se fare nuk ka qenë i sulmuar nga tani i ndjeri A. M. Në anën tjetër, duke arsyetuar dashjen e tij për të privuar nga jeta të ndjerin A., në këtë aktgjykim është konstatuar se dashja për të privuar nga jeta të ndjerin është formuar në çast, gjatë zhvillimit të ngjarjes. Mirëpo, nuk ka shpjegim se cilat veprime të tani të ndjerit apo personit tjerët, kanë ndikuar në marrjen e vendimit të këtillë të i dënuari dhe si shpjegohet veprimi i tij “në çast”.

Gjatë procedurës së shkallës së parë si dhe në ankesën e mbrojtësit të ushtruar kundër aktgjykimit të shkallës së parë, në mes tjerash është pretenduar se veprimet e të dënuarit janë ndërmarrë nga pakujdesia dhe se mund të bëhet fjalë për veprën penale të vrasjes nga pakujdesia ose për veprën penale të lëndimit të rëndë trupor me pasojë të vdekjes ose për veprën penale të vrasjes në gjendje të afektit mendor, mirëpo, aktgjykimi

i shkallës së parë ka arsyetim vetëm për mos ekzistimin e veprës penale të vrasjes nga pakujdesia por jo edhe për alternativat tjera të cekura më lartë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme këto paqartësi dhe mangësi në arsyet e aktgjyqimit të shkallës së parë të cilat nuk janë mėnjanuar me atë të shkallës së dytë paraqesin shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384.par.1.pika 12.të KPPK që për pasojë ka anulimin e tyre.

Në shqyrtimin e sërishëm duhet të vërtetohet se a ka ekzistuar sulmi i tani të ndjerit apo të ndonjë personi tjetër ndaj të dënuarit. Në këtë drejtim duhet të vlerësohet, në mes provave tjera, deklarata e dëshmitarit L. J. i cili ka thënë se pasi kan dal nga automjeti tani i ndjeri dhe personat tjerë nga ky grup, me mjete siç janë sopata e tj. dhe kanë shkuar në drejtim të dënuarit T., “T. është tërhequr mbarapa me revole në dorë, kurse B., E. dhe A. i kanë shkuar pas” dhe atëherë i dënuari ka shtënë me armë në drejtim të tokës. Për këtë rrethanë duhet të merren në konsideratë edhe të gjitha dëshmitë tjera të dëshmitarëve okular të ngjarjës kritike dhe të vlerësohen konform dispozitës së nenit 361.par.2.të KPPK. Lidhur me dashjën e të dënuarit për të privaur nga jeta tani të ndjerin, e cila sipas aktgjykimeve të kundërshtuara është formuar aty per aty, duhet të jepen arsye më të detaizuara në mënyrë që të mos ngelin mëdyshje nga të cilat varët aplikimi i drejt i së drejtës materiale.

Nga këto arsye, konform nenit 438.par.1.2. të KPPK u vendos që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen në pjesën që ka të bëjë me veprën penale të vrasjes nga neni 178.të KPK dhe lënda në këtë pjesë ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje ndërsa në pjesën që ka të bëjë me veprën penale përdorimi i armës apo njetit të rrezikshëm nga neni 375.par.2.të KPK aktgjykimet ngelen të paprekura dhe dënimi i shqiptuar për këtë vepër penale merret si i vërtetuar.

Gjykata Supreme gjeti se paraburgimi ndaj të dënuarit duhet të vazhdohet sepse bazat ligjore nga të cilat i njëjti është vazhduar ende qëndrojnë.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml.nr. 251/2016, më 01.11.2016.

Proçesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka